



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1008/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.N.T “DELTA-ING SOPJANI”, me seli në Magjistratja Prishtinë-Ferizaj, me NUI: ..., të cilin e përfaqëson E.S, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.138/21 të datës 26.02.2021, të Përmbartuesit Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 08.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.N.T “DELTA-ING SOPJANI”, me NUI:810444646, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.138/21 i datës 26.02.2021, i Përmbartuesit Privat Bardh Tasholli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.138/21 të datës 26.02.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit bashkangjitur këtij propozimi, shifra 127629, duke obliguar debitorin që shumën prej 265.92 € të bazuar në dokumentin e besueshëm në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit borxhin prej 265.92 €, si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës së Përmbartuesve Privat në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2014 për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve të Përmbartuesit Privat, në të kundërtën do të bëhet ndalimi i mjeteve në para të cilat debitori i ka në xhirollogarinë e tij bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë bankare të kreditorit nr.2011000024861916 TEB, ose nëse debitori nuk ka mjete në xhirollogarinë e tij, do të bëhet konfiskimi dhe shitja publike e sendeve të luajtshme të debitorit, dhe bartja e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se borxhi të cilin kreditori pretendon se ekziston në shumë prej 265.92 €, nuk ka bazë, për arsye se për furnizim me ujë debitori në bazë të faturave të prezantuara është barazuar me kreditorin. Tutje ka theksuar se kreditori kërkon shumën e mjeteve prej 265.92 €, me fatura të pa prezantuara dhe të pa pranuar nga ana e debitorit. Po ashtu, ka theksuar se debitori ka pranuar ujë nga kreditori disa herë me ndërprerje, ndalje dhe të gjitha faturat i ka paguar me rregull dhe deri me datën 20.01.2015 ka paguar shumën prej 1,452.00 €, ku në realitet kreditori ka mbetur borxh shumë prej 270.00 €. Andaj, i ka propozuar gjykatës që në kuptim të nenit 73 par.3 të LPP-së, të marrë aktvendim me të cilin aprovohet kundërshtimi/prapësimi si i bazuar, dhe të shfuqizohet Urdhri Përmbarimor i Përmbaruesit Privat P.nr.138/21 i datës 26.02.2021.

Kreditore në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, të pa argumentuar, si dhe i pa mbështetur në ligj dhe prova. Tutje ka theksuar se debitori faturohet si biznes dhe në lokalin të cilin posedon debitori përveç shpenzimeve të ujit debitori faturohet edhe për kanalizim. Po ashtu, ka theksuar se është e vërtetë që debitori ka paguar shumën prej 1,452.00 € dhe atë për borxhin deri në vitin 20.01.2015, nga janari i 2015 deri me 30.09.2016 debitori ka dal në parapagim, mirëpo kjo shumë prej 269.28 € është shlyer në muajt vijues, ndërsa borxhi për të cilin është dërguar në përmbarim është nga viti 31.10.2016 deri me datë 31.01.2021. Andaj, ka propozuar që gjykata prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar të pa argumentuar me prova dhe me ligj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerësoi urdhrin për përmbarim duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në*

lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareshmërisë së nxjerrë nga përmbareshi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbareshimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbareshi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbareshim nga përmbareshi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.” dhe gjeti se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbareshim.

Gjykata gjeti se përmbareshi privat ka lëshuar urdhrin për përmbareshimin sipas propozimit për përmbareshim të paraqitur nga kreditori, i cili propozim nuk i përmban elementet e përcaktuara në nenin 37 dhe 38 par. 1 të LPP-së.

Me nenin 37 të LPP-së është përcaktuar se: *“Kur propozimi për përmbareshim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 38 par. 1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Propozimi për përmbareshim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbareshim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbareshimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbareshimi, kërkuesi i përmbareshimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbareshimi, objekti i përmbareshimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbareshimit.”*

Në rastin konkret kreditori ka kërkuar përmbareshimin në bazë të Ekstraktit nga Librat e Kontabilitetit shifra 127629, mirëpo propozimit për përmbareshim nuk i është bashkëngjitur ekstrakti i lartcekur, siç përcaktohet me dispozitën e nenit 37 të LPP-së, por vetëm Kartela Financiare e Konsumatorit nr.3398 për periudhën 01.01.2013 deri me datën 26.02.2021, e cila nuk është në përputhje me propozimin për përmbareshim, përkatësisht nuk është dokumenti në bazë të të cilit është paraqitur propozimi për përmbareshim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se urdhri përmbareshimor është lejuar sipas propozimit për përmbareshim i cili nuk i përmban elementet e përcaktuara me LPP, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbareshit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1008/22, datë 08.05.2023

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.